

Ndryshime në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 7 *Instrumentat Financiarë: Dhënie informacionsh shpjeguese*

Është ndryshuar paragrafi 27. Janë shtuar paragrafët 27A dhe 27B.

Rëndësia e instrumentave financiarë për gjendjen dhe performancën financiare

Dhënie informacionesh të tjera shpjeguese

Vlera e drejtë

- 27 Një njësi ekonomike duhet të paraqesë informacion shpjegues për secilën klasë të instrumentave financiarë, për metodat e përdorura dhe nëse është përdorur një teknikë vlerësimi, për supozimet e zbatuara për përcaktimin e vlerës së drejtë të secilës klasë të aktiveve ose pasiveve financiare. Për shembull nëse është e zbatueshme, një njësi ekonomike jep informacion shpjegues mbi supozimet që lidhen me këstet e parapagesave, normat e humbjeve të vlerësuara nga kreditimi dhe normat e interesit ose të zbritjes. Nëse ka pasur ndonjë ndryshim në teknikat e vlerësimit, njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këtë ndryshim dhe arsyet për bërjen e këtij ndryshimi.
- 27A Për dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 27B një njësi ekonomike duhet të klasifikojë matjet e vlerës së drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e të dhënave bazë të përdorura në bërjen e matjes. Hierarkia e vlerës së drejtë duhet të ketë nivelet në vijim:
- (a) çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive ose pasive identike (Niveli 1);
 - (b) të dhënat bazë të tjera përveç atyre të çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1, që janë të vrojtueshme për aktivin ose pasivin, ose drejtpërdrejt (p.sh. çmimet) ose jo drejtpërdrejt (p.sh. që rrjedhin nga çmimet) (Niveli 2); dhe
 - (c) të dhënat bazë për aktivet ose pasivet që nuk bazohen në të dhënat e vrojtueshme në treg (të dhënat jo të vrojtueshme) (Niveli 3).
- Niveli i hierarkisë së vlerës së drejtë brenda së cilës matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e vet, duhet të përcaktohet në bazë të nivelit më të ulët të informacionit bazë që është i rëndësishëm për matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e vet. Për këtë qëllim, rëndësia e një informacioni bazë vlerësohet kundrejt matjes së vlerës së drejtë në tërësinë e vet. Nëse matja e vlerës së drejtë përdor të dhëna bazë të vrojtueshme që kërkojnë rregullime të rëndësishme të bazuara në të dhëna bazë jo të vrojtueshme, matja klasifikohet si matje e Nivelit të 3-të. Vlerësimi i rëndësishëm së një të dhëna bazë të caktuar për matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj kërkon gjykim, marrjen në konsideratë të faktorëve specifikë për aktivin ose pasivin.
- 27B Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për matjet e vlerës së drejtë të njohura në pasqyrën e gjendjes financiare për secilën klasë të instrumentave financiarë si vijon:
- (a) nivelin e hirarkisë së vlerës së drejtë në të cilin janë kategorizuar në tërësinë e tyre matjet e vlerës së drejtë, duke veçuar matjet e vlerës së drejtë në përputhje me nivelet e përcaktuara në paragrafin 27A.
 - (b) çdo transferim të rëndësishëm mes Nivelit 1 dhe Nivelit 2 në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe arsyet për këto transferime. Transferimet drejt secilit nivel duhet të paraqiten në informacionet shpjeguese veçmas dhe të trajtohen veçmas nga transferimet nga secili nivel. Për këtë qëllim, rëndësia duhet të gjykohet lidhur me fitimin ose humbjen dhe aktivet ose pasivet gjithsej.
 - (c) për matjet e vlerës së drejtë të Nivelit 3 në hirarkinë e vlerës së drejtë, një përmbledhje nga gjendja fillestare deri në përfundim duke paraqitur veçmas ndryshimet gjatë periudhës që lidhen me sa vijon:

- (i) fitimet ose humbjet gjithsej të periudhës të njohura në rezultatin e periudhës dhe një përshkrim se ku janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave gjithsej ose të pasqyrës së veçantë të të ardhurave (nëse paraqitet);
 - (ii) fitimet ose humbjet e njohura në të ardhurat e tjera gjithsej;
 - (iii) blerjet, shitjet, emetimet dhe shlyerjet (secili tip lëvizjeje i paraqitur veçmas); dhe
 - (iv) transferimet drejt ose nga Niveli 3 (psh. Transferimet që takojnë ndryshimeve në vrojtueshmërinë e të dhënave të tregut) dhe arsyet për këto transferime. Për transferimet e rëndësishme, transferimet drejt Nivelit 3 duhet të jepen informacione shpjeguese dhe të trajtohen veçmas nga transferimet nga Niveli 3.
- (d) shuma e fitimeve ose humbjeve gjithsej të periudhës në pikën (c)(i) më sipër e përfshirë në rezultatin e periudhës që u takon fitimeve ose humbjeve që lidhen me ato aktive ose pasive të mbajtura në fund të periudhës së raportimit dhe një përshkrim se ku janë paraqitur këto fitime ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithsej ose në pasqyrën e veçantë të të ardhurave (nëse paraqitet).
- (e) për matjet e vlerës së drejtë të Nivelit 3, nëse ndryshimi i një ose më shumë të dhënave bazë si pasojë e supozimeve alternative të mundshme me besueshmëri të kënaqshme, do të ndryshojë në mënyrë të rëndësishme vlerën e drejtë, njësia ekonomike duhet të paraqesë këtë fakt dhe të japë informacion shpjegues për këto ndryshime. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues sesi llogaritet efekti i një ndryshimi në një supozim alternativ të mundshëm me besueshmëri të kënaqshme. Për këtë qëllim rëndësia duhet të gjykohet në lidhje me fitimin ose humbjen dhe aktivet ose pasivet gjithsej ose në kapitalin e vet gjithsej, nëse ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur në të ardhurat gjithsej të tjera.

Një njësi ekonomike duhet të paraqesë shënimet shpjeguese sasiore të kërkuara nga ky paragraph në format tabelle përveçse atëhere kur një format tjetër është më i përshtatshëm.

Është ndryshuar paragrafi 39. është shtuar paragrafi 44G.

Risku i likuiditetit

- 39 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues si vijon:
- (a) një analizë të maturimit për pasivet financiare jo-derivative (përfshirë kontratat e emetuara të garancisë financiare) që tregon maturimin e mbetur sipas kontratës.
 - (b) një analizë të maturimit të pasiveve financiare derivative. Analiza e maturimit duhet të përfshijë maturimin e mbetur sipas kontratës për ato pasive financiare derivative për të cilat maturimi sipas kontratës është thelbësor për të kuptuar më mirë fluksin kohor të mjeteve monetare (shih paragrafin B11B).
 - (c) një përshkrim sesi ajo menaxhon riskun e likuiditetit të pranishëm në pikat (a) dhe (b).

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- 44G *Përmirësimi i Dhënies së Informacioneve Shpjeguese rreth Instrumentave Financiarë* (Ndryshime në SNRF 7), publikuar në Maj 2009, ndryshoi paragrafët 27, 39 dhe B11 dhe shtoi paragrafët 27A, 27B, B10A dhe B11A–B11F. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2009 ose më pas. Nuk kërkohet që në vitin e parë të zbatimit një njësi ekonomike të japë informacion krahasues për dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga ndryshimet. Lejohet zbatimi më herët. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Shtojca A

Termet e përcaktuar

Është ndryshuar termi në vijim.

Risku i likuiditetit Risku që një njësi ekonomike do të ndeshë vështirësi në plotësimin e detyrimeve që lidhen me pasivet financiare që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvrimin të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar.

Shtojca B

Udhëzim për zbatim

Është ndryshuar një titull dhe paragrafi B11. Janë shtuar paragrafët B10A dhe B11A–B11F dhe janë fshirë paragrafët B12–B16. Paragrafët B12 dhe B13 janë zëvendësuar me paragrafin B11C(a) dhe (b). Paragrafët B14 dhe B16 janë zëvendësuar me paragrafin B11D.

Natyra dhe madhësia e risqeve që vijnë nga instrumentat financiarë (paragrafët 31–42)

Dhënie informacionesh shpjeguese sasiore për riskun e likuiditetit (paragrafët 34(a), 39(a) dhe (b))

- B10A Në përputhje me paragrafin 34(a) një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues sasiore dhe përmbledhës mbi ekspozimin ndaj riskut të likuiditetit bazuar në informacionin e brendshëm që siguron personeli drejtues kyç. Një njësi ekonomike duhet të shpjegojë sesi janë përcaktuar këto të dhëna. Nëse fluksi dalës i mjeteve monetare (ose një aktiv tjetër financiar) i përfshirë në këto të dhëna mundet ose:
- (a) të ndodhë shumë më herët sesa data e paraqitur, ose
 - (b) të jetë për shumën shumë të ndryshme nga ato të paraqitura në të dhënat (p.sh. një derivativ që përfshihet në të dhëna mbi baza shlyerje neto por për të cilin pala tjetër ka opsionin që të kërkojë shlyerjen mbi baza bruto),
- njësia ekonomike duhet të paraqesë këtë fakt dhe të japë informacion sasiore që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë madhësinë e këtij risku përveçse kur ky informacion është përfshirë në analizën e maturimit sipas kontratës të kërkuar nga paragrafi 39(a) ose (b).
- B11 Në përgatitjen e analizës së maturimit të kërkuar nga paragrafi 39(a) dhe (b) një njësi ekonomike përdor gjykimin e saj për të përcaktuar numrin përkatës të hapësirave kohore. Për shembull një njësi ekonomike mund të përcaktojë që janë të përshtatshme hapësirat kohore në vijim:
- (a) jo më vonë se një muaj;
 - (b) më vonë se një muaj dhe jo më vonë se tre muaj;
 - (c) më vonë se tre muaj dhe jo më vonë se një vit; dhe
 - (d) më vonë se një vit dhe jo më vonë se pesë vjet.
- B11A Për të plotësuar kërkesat e paragrafit 39(a) dhe (b), një njësi ekonomike nuk duhet të veçojë një derivativ që vjen nga një instrument financiar hibrid (i kombinuar). Për një instrument të tillë njësia ekonomike duhet të zbatojë paragrafin 39(a).
- B11B Paragrafi 39(b) kërkon që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për analizën sasiore të maturimit për pasivet financiare derivative që tregon maturimin e mbetur sipas kontratës nëse maturimi sipas kontratës është thelbësor për të kuptuar kohën e flukseve të mjeteve monetare. Për shembull ky do të ishte rasti i:
- (a) normës së interesit të një kontrate swap me maturim të mbetur për pesë vite në një kontratë mbulimi të mjeteve monetare (hedge) me norma variabël të aktivitetit ose pasivit financiar.
 - (b) të gjitha angazhimeve të huasë.
- B11C Paragrafi 39(a) dhe (b) kërkon që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për analizën e maturimit të pasiveve financiare që tregon maturimin e mbetur sipas kontratës për disa pasive financiare. Në këtë dhënie informacionesh shpjeguese:

Amendments to IFRS 7

- (a) nëse një palë mund të zgjedhë se kur paguhet një shumë, pasivi shpërndahet në periudhën më të hershme në të cilën njësisë ekonomike mund t'i kërkohej pagesa. Për shembull pasivet financiare që një njësi ekonomike duhet të shlyejë kur i kërkohej (p.sh. depozitat në të parë) përfshihen në hapësirën kohore më të hershme.
 - (b) nëse një njësi ekonomike angazhohet të vërë në dispozicion shuma me këste, secili këst shpërndahet në periudhën më të hershme në të cilën njësisë ekonomike do t'i duhet të paguajë. Për shembull një angazhim për tërheqjen e huasë përfshihet në hapësirën kohore që përmban datën më të hershme kur ky angazhim mund të tërhiqet.
 - (c) për kontratat e emetuara të garancisë financiare shuma maksimale e garancisë shpërndahet në periudhën më të hershme në të cilën mund të kërkohej garancia.
- B11D** Shumat e kontraktuara të paraqitura në analizat e maturimit sipas kërkesave të paragrafit 39(a) dhe (b) janë flukse monetare kontraktuale jo të skontuara, për shembull:
- (a) detyrimet bruto për kontratat e qirasë financiare (para zbritjes së komisioneve financiare);
 - (b) çmimet e specifikuar në marrëveshjet e së ardhmes për të blerë aktive financiare me mjete monetare;
 - (c) shumat neto për kontratat swap me norma interesi fikse për të cilat këmbehen flukse neto në mjete monetare;
 - (d) shumat e kontraktuara për t'u këmbyer në një instrument financiar derivativ (p.sh. këmbim valutash) për të cilat këmbehen flukse bruto në mjete monetare; dhe
 - (e) angazhimet bruto të huasë.
- Flukse të tilla të mjeteve monetare jo të skontuara ndryshojnë nga shuma e përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar sepse shuma në këtë pasqyrë bazohet në flukset e skontuara monetare. Nëse shuma e pagueshme nuk është fikse, shuma e paraqitur përcaktohet duke ju referuar kushteve ekzistuese në fund të periudhës së raportimit. Për shembull nëse shuma e pagueshme varion me ndryshimet në një indeks, shuma e paraqitur mund të bazohet në nivelin e atij indeksi në fund të periudhës.
- B11E** Paragrafi 39(c) kërkon që një njësi ekonomike të përshkruajë sesi menaxhon riskun e likuiditetit të pranishëm në zërat e paraqitur në informacionet shpjeguese sasiore të kërkuara në paragrafët 39(a) dhe (b). Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për analizën e maturimit të aktiveve financiare që mban lidhur me manaxhimin e riskut të likuiditetit (p.sh. aktivet financiare që janë gati për shitje ose që pritet të krijojnë flukse hyrëse monetare për të përballuar flukset dalëse në pasive financiare), nëse ky informacion është i nevojshëm për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave të saj fiannciare vlerësimin e natyrës dhe madhësisë së riskut të likuiditetit.
- B11F** Faktorë të tjerë që mund të marrë në konsideratë një njësi ekonomike lidhur me dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara në paragrafin 39(c) përfshijnë por nuk kufizohen në sa më poshtë. Nëse një njësi ekonomike:
- (a) është angazhuar në marrjen hua të ndryshme (p.sh. letrat tregtare) ose mënyra të tjera kreditimi të cilave mund t'u drejtohet për të përballuar nevojat e veta për likuiditete;
 - (b) ka depozita në bankat qendrore për të plotësuar nevojat për likuiditete;
 - (c) ka burime shumë të ndryshme financimi;
 - (d) ka përqendrim të rëndësishme të riskut të likuiditetit ose në aktivet e veta ose në burimet e veta të financimit;
 - (e) ka procese të kontrollit të brendshëm dhe plane rezervë për menaxhimin e riskut të likuiditetit;
 - (f) ka instrumenta që përmbajnë kushte të përshpejtuara shlyerjeje (p.sh. më rënien e klasifikimit të aftësisë kredimarrëse të njësisë ekonomike);
 - (g) ka instrumenta që mund të kërkojnë vendosjen e një kolaterali (psh. marzhe për thirrjen e derivativëve);
 - (h) ka instrumenta që lejojnë njësinë ekonomike të zgjedhë nëse të shlyejë pasivet e veta fiannciare në mjete monetare (ose një aktiv tjetër financiar) ose duke dhënë aksione të veta; ose

Amendments to IFRS 7

- (i) ka instrumenta që janë objekt i marëveshjeve që rregullohen mbi baza neto
B12-B16 [Fshirë]

Ndryshime në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 4 *Kontratat e Sigurimit*

Është ndryshuar paragrafi 39(d).

Dhënie informacionesh shpjeguese

Natyra dhe madhësia e risqeve që vijnë nga kontratat e sigurimit

- 39 (d) informacion rreth riskut të kredisë, riskut të likuiditetit dhe riskut të tregut që do të kërkonin paragrafët 31–42 të SNRF 7 nëse kontratat e sigurimit do të jenë brenda objektit të SNRF 7. Megjithatë:
- (i) një sigures nuk ka nevojë të parqesë analizën e maturimit të kërkuar në paragrafin 39(a) dhe (b) të SNRF 7 nëse ai jep informacion shpjegues rreth kohës së flukseve dalëse monetare që do të vinin nëse njihen pasivet e siguruara. Kjo mund të marrë formën e një analize duke vlerësuar kohën, e shumave të njohura në pasqyrën e gjendjes financiare.
 - (ii) ...